


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1 VIT	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	+0.54%	+2.00%	+1.39%	+18.18%	+27.16%	+34.78%
BENÇMARKU*	0.00%	-1.19%	-0.24%	-0.32%	+4.11%	+30.57%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM2 2016

ÇMIMI I AKSIONIT:

PRILL	▲ +0.37%
MAJ	▲ +1.07%
QERSHOR	▲ +0.54%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▲ +2.00%

KTHIMI BRUTO:

PRILL	+€5.22 mln
MAJ	+€14.28 mln
QERSHOR	+€7.69 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	+€27.20 mln

FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT €1.3478	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,323,691,671.57
PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €4.68 mln	PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT €9.50 mln
LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR 1,109	LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT 2,277
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 522,724	LLOGARI AKTIVE KËTË VIT 272,714
KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT 14,779	KONTRIBUTE KËTË TREMUJOR €37.96 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT 39,660	GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI 55,890

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€343,397,345.75	26.00%	+1.05%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€214,837,346.01	16.22%	+4.06%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€9,901,088.66	0.75%	+0.78%
Nordea	1-Stable Return Fund	€184,454,298.27	14.17%	+1.71%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€99,776,769.00	6.45%	+3.93%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€103,295,185.32	7.80%	+0.54%
KBI	Divident Plus	--	--	+1.37%**
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€133,349,467.51	10.07%	+5.29%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€41,331,940.53	3.12%	+3.67%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€57,816,198.72	4.37%	-0.15%
BANKA KOMBËTARE TREGTARE	Depozitë me afat	€3,034,442.84	0.23%	+0.33%*
BANKA PËR BIZNES SH.A.	Depozitë me afat	€3,030,452.05	0.23%	+0.29%*
GJITHSEJ MJETE TË INVESTUARA		€1,184,005,719.78	89.40%	+0.33%

*Performanca në këto raste është për çështje ilustrimi dhe nuk lidhet me investimin, pasi janë depozita me afat, me interes të paracaktuar. Norma e paraqitur është për interesin e mbledhur për periudhën 31 mars 2016 deri më 30 qershor 2016.

**I gjithë investimi nga ky fond është tërhequr më 28.06.2016 dhe performanca e kthimit nga investimi vlen për periudhën 31.03.2016 deri 28.06.2016.

€27.2 MLN KTHIMI BRUTO PËR TM2

Pas tremujorit të parë, me oscilime të forta në tregje, tremujori i dytë ishte më i ekuilibruar dhe me rritje më të madhe të tregjeve financiare. Njëkohësisht, strategjia investuese e FKPK-së vazhdon të jetë mjaft inkurajuese duke vjelur me sukses mundësitë e tregjeve në ngritje. Si rezultat kthimi bruto nga investimet për TM2 ishte rreth €27.2 mln, kurse kthimi nga investimet për vitin shkoi në rreth €33.4 mln. Kjo performancë u reflektua me një rritje neto prej 2% të çmimit të njësisë për TM2, dhe me çmimin e aksionit që arriti në €1.3478. Për shkak të, kryesisht, performancës mjaft pozitive nga investimet, mjetet nën menaxhim u ngritën për 58.6 mln në TM2, për të shkuar kështu në €1.32 mld. Në anën tjetër për këtë tremujor FKPK-ja mbajti €263 mijë për tarifën operacionale, €1.28 mln për tarifën investuese dhe rreth €386 mijë ishin refondime.

FAKTORËT ME NDIKIM

Ky tremujor ishte nën ndikim pozitiv nga stabilizimi i çmimit të naftës dhe nga sinjalet se ngritja e mëtejme e normave bazë të interesit nuk do të ndodhë nga FED-i në një të ardhme të afërt. Gjithsesi faktori kryesor me efekt negativ dhe me rënie të shpejtë të indekseve, ishte rezultati i papritur i referendimit në Mbretërinë e Bashkuar, që i hapi asaj rrugën e daljes nga BE. Megjithatë, për shkak se - përveç rezultatit të papritur - ky proces nuk pritet të shkaktojë efekte të tjera menjëherë, tregjet e rikuperuan shumë shpejt këtë rënie.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Tetë nga nëntë fondet investuese të angazhuara e mbyllën këtë periudhë në nivele pozitive. Fondi i vetëm (AXA-OI) ishte në kuotë minimale negative (-0.15%) për TM2, i ndikuar kryesisht nga rritja e prezencës në portofol e bonove sovraane evropiane, të cilat edhe në TM2 ndikuan negativisht. Nga fondet me rritje, Nordea-GSEF ishte bindshëm më mirë (+5.29%), duke vazhduar të ketë avantazh alokimin gjeografik (përqendrimin në SHBA) dhe atë sektorial (me gati 70% të portofolit në katër sektorë). Më pas ishte fondi në multi-asete i BNY Mellon me +4.06% për TM2, duke përfituar nga prezenca në portofol e investimeve në kompani që e kanë arin si biznes, si dhe nga vlerësimi i investimeve të tyre në Thesarin e SHBA-ve. Jo larg ishte fondi i AXA-GILB, që përfitoi nga rritja e inflacionit si pasojë e zhvlerësimit (sidomos) të sterlinës britanike. Me +3.67% u rendit i katërti fondi i Pictet, me pozicionim në aksionet e kompanive që ofrojnë shërbime publike si: ujë, gaz, energji e me radhë. Fondi i multi-aseteve i Nordea SRF (me +1.71%), dhe ai i pastër në aksione i Vanguard (me +1.05%), nuk përfituan më shumë në këtë tremujor; kryesisht për shkak të performancës negative të investimeve në tregjet në zhvillim, që kanë peshë në investimet e dy fondeve.

Investimet në Kosovë ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe nuk ndikohen nga faktorë të jashtëm. Interesi i mbledhur për periudhën për investimet në depozita ishte mesatarisht 0.31%, dhe për bono 0.54%. Ndërkohë, likuiditeti i lartë në banka vazhdoi të rrisë presionin në uljen e normave të kamatave të ofertuara për fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës, duke i çuar ato në nivele afër zeros. Për ilustrim: në ankandin e 5 majit për letra me maturim 91 ditësh oferta minimale kishte zbritur në 0.05%.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE NË TM2

+2.00%

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE PËR VITIN

+2.33%

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E DYTË PËR VITIN

Në mbledhjen e qershorit Bordi ka marrë këto vendime:
1) Tërheqjen e gjithë investimit prej €65 mln nga fondi i KBI – IDEF; 2) Investimin e €50 mln shtesë në fondin e Nordea 1-GSEF; 3) Tërheqjen e €18 mln nga fondi AXA GILB; 4) Investimin e €15 mln shtesë në letrat me vlerë të Kosovës; 5) Angazhimin e tri fondeve të reja investuese, me nga €40 mln secili, përkatësisht: a) Deutsche Asset Management; b) Amundi AM; c) BNP Paribas; 6) Ndryshimin e caqeve të strategjisë investuese.

RRITET BAZA MUJORE E TËRHEQJES NË FAZA

Banka Qendrore e Kosovës ka miratuar kërkesën e FKPK-së që të ndryshojë shumë e tërheqjes mujore të kursimeve pensionale në programin me faza nga 1 qershori 2016. Kështu, kontribuuesit me bilanc deri në €2,250 gjithë shumën do të mund ta tërheqin me një pagesë të vetme, ndërsa mbi këtë shumë tërheqja e kursimeve bëhet në faza prej €200 në muaj (për bilancet deri €20 mijë) ose 1% e shumës (për bilancet mbi €20 mijë), derisa e gjithë shuma të shterojë. Përfituesit e tërheqjes në faza (pra me kursime mbi 2,250 euro) do të vazhdojnë të kenë mundësinë e tërheqjes së 20% të kursimeve në një tërheqje të vetme në momentin e pensionimit.

U NDRYSHUAN DHE U PËRSHTATEN CAQET E STRATEGJISË INVESTUESE

Bordi Drejtues në mbledhjen e qershorit 2016 ka vendosur që t'i përshtasë dhe ndryshojë caqet e strategjisë investuese si në vijim:
1) Aksionet/Menaxhim risku nga 8% në 10%
2) Aksione/Të ardhura nga 8% në 5% dhe
3) Kesh nga 4% në 5%

Këto ndryshime erdhën si nevojë për rritjen e mundësive investuese në instrumente të caktuara, por edhe përshtatje me angazhimin e fondeve të reja investuese në vijim.

DELEGACIONI I FKPK-SË TAKIM ME KRYETARIN E KUVENDIT

Delegacionin i FKPK-së i udhëhequr nga Kryesuesi i Bordit Drejtues, z. Ymer Havolli, i ia dorëzoi Kryetarit të Kuvendit, z. Kadri Veseli, Raportin Vjetor 2015 dhe e informoi në pika të shkurtëra me përmbajtjen e raportit dhe zhvillimin e përgjithshëm të institucionit prej themelimit. Nga ana tjetër, z. Veseli e ka çmuar punën e vyer që Bordi dhe Menaxhmenti i FKPK-së ka bërë, dhe i ka përgëzuar për realizimin profesional të raportit vjetor, për rezultatet pozitive nga investimi i mjeteve si dhe transparencën e këtij institucioni.

4.7 MLN PENSIONE NË TM2

Rreth €4.7 mln ishin mjetet që u transefuran në llogaritë e pensionuara në tremujorin e dytë. Këto mjete shkuan tek 1,109 përfitues të pensionit. Nga këta: 868 ishin pensionime të moshës, 202 ishin raste të invaliditetit dhe 30 ishin raste të vdekjes.

Për gjysmën e parë të vitit 2016 vlera e mjeteve të transferuara tek të pensionuarit ka arritur në rreth 9.5 mln për 2,277 përfitues.

55,890 LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të TM2 arriti në 55,890 ose një rritje prej 7% nga tremujori paraprak. Analizuar ndryshe del se rreth 11% e të gjithë kontribuuesve (522,724) kanë aktualisht llogari në eTrusti. Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Korrik 2016

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025
Zyra Qendrore: +381-38-244-341

info@trusti.org
www.trusti.org